



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 97 Akti

Nr. 154 Vendimi  
Tiranë, më 10.06.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Roland Ilia</b>	<b>Relator</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 5 qershor 2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Znj. Enkeledi Hajro**, me detyrë gjyqtare/kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në pikën 5, të nenit 3, dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, gjyqtare/kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka hedhur shortin në datën 15.3.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. \*\*\*, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Olsi Komici dhe Valbona Sanxhaktari. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Roland Ilia.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues në datën 21.3.2018 u caktua me mirëkuptim kryesues, komisioner Olsi Komici, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me subjektin.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. \*\*\*, datë 26.12.2018), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro.*

10. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit me nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2018, ardhur në KPK me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.4.2018.

11. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit, atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës në datën 22.5.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit në datën 22.5.2019 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 24.5.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 27.5.2019.

14. Subjekti i rivlerësimit pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 5.06.2019 vendosi të ftojë znj. Enkeledi Hajro, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, më datë 3.6.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 5.6.2019, ora 14:00 në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Znj. Enkeledi Hajro, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar

të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur ato janë kërkuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Referuar vendimit Nr. 2/2017<sup>[1]</sup>, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;

---

<sup>[1]</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- c) “Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLD;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka mosdeklarime të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

ILDKPKI është shprehur se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, ka bërë deklaram të pasaktë për shkak se nuk ka deklaruar kërkesën për legalizim me sip. 12 m<sup>2</sup> dhe ka pasaktësi lidhur me vlerat e të ardhurave të saj dhe bashkëshortit.

### **2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarameve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, me nr. indeksi \*\*\*, datë 30.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklarameve të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2016, në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”;

- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisionit.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting” të dorëzuar në ILDKPKI subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

- ❖ **Apartament banimi (1+1)**, me sip. 46.2 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, k. \*\*\*, Shkodër, blerë në datën 8.6.1998, në bashkëpronësi me nënën, znj. M.Sh. Pjesa takuese: 50%.

*Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”*

Përfitur falas si ish e përndjekur politike nga dega e Entit Kombëtar të Banesave Shkodër.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja Shkodër.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2018, ZVRPP-ja Shkodër, konfirmon se kjo pasuri është regjistruar në bashkëpronësi në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe të nënës së saj, znj. M.A. Sh. Kjo pasuri rezultoi e blerë në datën 8.6.1998 nga subjekti i rivlerësimit me palë shitëse degën e Entit Kombëtar të Banesave Shkodër. Në nenin “c” të kontratës është përcaktuar se meqenëse blerësi e ka statusin e ish të përndjekurit politik në zbatim të VKM-së nr. 476, datë 10.10.1994, e privatizon banesën falas.

### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni konstatoi se deklaratimet e subjektit janë në përputhje me përgjigjen e ZVRPP-së Shkodër dhe dokumentet shkresor të administruar në dosje.

Nisur nga fakti se kjo pasuri është përfitur siç përcaktohet në kontratë bazuar në statusin si ish të përndjekur politikë është përfitur falas nga shteti. Në këtë kohë subjekti nuk ka qenë në funksion si gjyqtare prandaj nuk kanë lindur dyshime të mëtejshme për këtë pasuri.

- ❖ **Njësi tregtare me sip. 22 m<sup>2</sup>**, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Shkodër, me vlerë 4,396 lekë, e përfitur nga privatizimi. Pjesa takuese: 100 %.

*Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”*

Nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Subjekti ka deklaruar njësi me sip. 22 m<sup>2</sup>, referuar vërtetimit hipotekor nr. \*\*\*, datë 9.5.1996, sipas ALUIZNI-t, ka rezultuar se subjekti ka bërë shtesë me sip. 12.5 m<sup>2</sup> aplikuar me vetëdeklarimin nr. \*\*\*, datë 13.1.2006. Për këtë shtesë ka rezultuar se nuk është miratuar akoma legalizimi.

Gjatë hetimit të kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si pasuri të paluajtshme “njësi” me sip. 22 m<sup>2</sup>, referuar vërtetimit hipotekor nr. \*\*\*, datë 9.5.1996, në qytetin e Shkodrës. Sipas të dhënave të dërguara nga ALUIZNI, ka rezultuar se për këtë pasuri, subjekti ka bërë kërkesë për shtesë objekti me sip. 12.5 m<sup>2</sup>, aplikuar për vetëdeklarim pranë këtij Insitucioni me nr. \*\*\*, datë.13.1.2006.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2018, ALUIZNI Shkodër, ka dërguar të dhëna lidhur me aplikimin për legalizim. Sipas kësaj praktike rezultoi se këtë pasuri me sip. 22 m<sup>2</sup> subjekti e

ka blerë në vitin 1992 nga dega e Agjencisë së Privatizimit Shkodër në vlerën prej 4,396 lekë. Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Shkodër dhe është lëshuar vërtetim hipotekor në datën 30.12.2011, për pasurinë nr. \*\*\* me sip. 22 m<sup>2</sup>.

Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit për legalizim të shtesës në objektin e privatizuar dhe në pronësi, pranë ALUIZNI-t, në vitin 2006. Sipas këtij formulari të vetëdeklarimit, subjekti ka kërkuar për tu përfshirë në legalizim 2 hapësirat përpara dyqanit në vijë të drejtë me murin e jashtëm dhe një shtesë brenda objektit e cila nuk është përfshirë në procedurën e privatizimit.

Komisioni për këtë pasuri konstatoi se:

- Blerja e pasurisë nga ana e subjektit është bërë në periudhën kur subjekti nuk kishte mbushur moshën për fitimin e zotësisë juridike për të vepruar sepse në kohën e blerjes së pasurisë nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç, si dhe nuk kishte qenë në marrëdhënie pune për të krijuar të ardhura.  
*Për këtë është pyetur subjekti e cila ka deklaruar se procedura e privatizimit është ndjekur nga daja i saj, z. G.Sh., për llogari të subjektit deri në përfundim të procesit të privatizimit, privatizim i kryer nga institucionet shtetërore.*
- Dukej se nga ana e subjektit ishte kryer ndërtim pa leje dhe më pas ishte aplikuar për legalizim të tij.  
*Për këtë çështje është pyetur subjekti e cila ka deklaruar se aplikimi për legalizim është bërë vetëm pasi në privatizim nuk është vendosur saktë sipërfaqja e cila duhet të ishte 34,5 m<sup>2</sup> dhe jo 22 m<sup>2</sup>. Për këtë njësi nuk është kryer asnjë investim vetëm disa punime të brendshme dhe nuk është bërë ndonjë shtesë pa leje. Për këto arsye ALUIZNI nuk e ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka vendim për lëshim akti administrativ për legalizim objekti.*

Rezultoi se për këtë aplikim dhe për shtesën e objektit nuk është miratuar akoma leja e legalizimit nga ALUIZNI, si akt për fitimin e pronësisë.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8. 5.2019, drejtorja e ALUIZNI-t Shkodër, ka kthyer përgjigje për këtë çështje ku rezulton se objekti në proces legalizimi është ndërtuar para vitit 1991 dhe nuk i nënshtrohet procedurave kualifikuese për legalizim të përcaktuar në VKM-në nr. 280, datë 1.4.2015. Gjithashtu, në shkresë theksohet se subjekti duhet ti drejtohet ALUIZNI-t, për të aplikuar për kalim pronësie për objekt të ndërtuar para vitit 1991 sipas VKM-së nr. 442, datë 18.7.2018.

Për sa më sipër ju kërkuan shpjegime subjektit lidhur me kërkesën e bërë për legalizim dhe për faktin se në periudhën e privatizimit dhe lidhjes së kontratës së shitblerjes subjekti nuk ishte në moshën e përcaktuar nga ligji për zotësinë për të vepruar. Gjithashtu, ju kërkuan shpjegime pse është ndjekur nga subjekti kjo rrugë për legalizim objekti pa leje dhe jo procedura për rishikimin e kontratës së privatizimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi: “Kjo pasuri është përfituar për shkak të statusit si ish e përndjekur politike. Procedura e privatizimit është ndjekur nga daja im, z. G.Sh. Ky veprim u ndërmor pasi na sugjeruan që kjo situatë mund të zgjidhet nga ALUIZNI. Kjo pasuri është në kufijtë e saj të pandryshueshëm, siç, ka qenë që nga momenti i privatizimit. Megjithatë në momentin më të përshtatshëm do të ndjek procedurat e nevojshme ligjore sipas sugjerimit të ALUIZNI-t”.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni bazuar në përgjigjet e subjektit, shkresat e dërguara nga ALUIZNI, si dhe nga dokumentacioni i ndodhur në dosje, konstatoi se subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues lidhur me burimet e ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie dhe as dokumentacion

provues që procedura për privatizim është ndjekur nga daja i saj. Subjekti në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie të paluajtshme nuk e kishte fituar zotësinë për të vepruar.

Gjithashtu, Komisioni thekson se në momentin e fitimit të pronësisë subjekti nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtarës dhe as funksione të tjera në administratën shtetërore dhe, nuk ka qenë subjekt deklarues për pasurinë.

- ❖ **Apartament banimi** në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe funksionale 85 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Vlera 82,000 euro.  
*Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”*  
Kredi e marrë nga “Alpha Bank” në vlerën prej 70,000 eurosh e cila më pas në shtator të vitit 2012, në vlerën prej 8,600,000 lekësh është blerë nga “BKT”-ja.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ZQRPP-së.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këtë pasuri e ka blerë me kredi të marrë nga “Alpha Bank” në vlerën prej 70,000 eurosh, pasi banka mbulonte vetëm 70 % të vlerës së blerjes së apartamentit dhe kontratës së kredisë për blerje apartamenti në datën 31.7.2007. Kjo kredi është blerë më pas nga “BKT”-ja, në shtator të vitit 2012, në vlerën prej 8,600,000 lekësh, e cila përbëhet nga dy kredi: (1) njëra shtetërore në vlerën 5,000,000 lekë me interes fiks 4 %; dhe (2) tjetra kredi tregtare në vlerën 3,600,000 lekë me interes të ndryshueshëm. Vlera e deklaruar e apartamentit 82,000 euro. Subjekti ka deklaruar se zotëron ½ pjesë të këtij apartamenti.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2018, ZVRPP-ja Tiranë, ka dërguar të dhëna lidhur me pasurinë, apartament me sip. 85 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*. Kjo pasuri rezulton e bllokuar në emër të “BKT”-së, në datën 13.9.2012, për efekt të kredisë së marrë në këtë bankë, në shumën prej 8,600,000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

Rezultoi se në datën 31.7.2007, subjekti ka lidhur kontratë për kufi kredie shumë-qëllimore nr. \*\*\*, datë 31.7.2007, në “Alpha Bank”. Kjo kredi është marrë duke vendosur në hipotekë në favor të bankës pasurinë nr. \*\*\*. Me pas kjo kredi është shlyer nga “BKT”-ja.

Bazuar në kontratën e shitjes me rezervë të pasurisë, apartament nr. \*\*\* (kontrata nr. \*\*\*, datë 21.6.2007), rezultoi se ky apartament është blerë nga ana e subjektit në vlerën prej 82,000 eurosh. Pagesa do bëhej me dy këste. Kësti i parë do paguhej në datën e lidhjes së kontratës në datë 21.6.2007, në shumën prej 7.000 eurosh dhe kësti i dytë prej 75.000 eurosh do likuidohej deri në datën 30.7. 2007 nëpërmjet një kredie bankare që do merrej nga subjekti i rivlerësimit në “Alpha Bank”.

Për këtë pasuri është pyetur subjekti e cila ka deklaruar: *“Lidhur me këtë pyetje sqaroj se vlera reale e blerjes së apartamentit ka qenë 70,000 (shtatëdhjetëmijë) euro, por me palën blerëse arritëm në marrëveshje që në kontratë të shkruhej vlera 82,000 euro me qëllim që banka të më debitonte vlerën që i korrespondonte vlerës së blerjes së apartamentit sipas ofertës me 70 %. Prandaj, sikurse ju kam dërguar në përgjigjen time të datës 25 shkurt 2019, pyetja 8, Aneksi VI, deklarata e datës 12.9.2012 e lëshuar nga “Alpha Bank” provon pikërisht këtë fakt: që më janë debituar 70,000 euro për blerje apartamenti por të ndarë në dy këste: blerje dhe rikonstruksion sepse kësti i parë 55,000 euro janë 70 % dhe 82,000 euro (vlera e blerjes) sikurse ishte edhe oferta e bankës dhe rikonstruksion 15,000 euro që në fakt i është shtuar shumës totale të kredisë për blerjen e apartamentit prej 70,000 eurosh. Banka në atë kohë për të miratuar dhe lëvruar kredinë e kërkuar nga ana jonë, propozoi dhe realizoi këtë mënyrë dhe përmbushi kërkesën tonë. Duhet të sqaroj që ne kemi blerë një apartament të ri, të përfunduar*



*që nuk kishte nevojë për asnjë rikonstrukcion. Për sa më lart, deklaroj se nuk kam pasur asnjëherë 12,000 euro cash dhe palës shitëse A.K., i kam paguar vetëm vlerën e apartamentit prej 70,000 euro që është transferuar me bankë konkretisht: shuma prej 55,000 eurosh është lëvruar në datën 3.8.2007 dhe vlera prej 15,000 eurosh është lëvruar në datën 12.3.2008, çka provohet nga statementi “Alpha Bank” Aneksi VI me përshkrimin përkatës “për blerje apartamenti””.*

Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie. Vlera e apartamentit është llogaritur në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, bazuar në vlerën e kontratës së lidhur, në deklaramet e subjektit, në deklaramtën para fillimit të detyrës, si dhe në deklaramtën “Vetting”, në shumën prej 82,000 eurosh.

Subjektit të rivlerësimit, me dërgimin e rezultateve të hetimit, iu kërkua të sqaronte dhe të dokumentonte me dokumente shkresore provuese, nëse vlera prej 82,000 eurosh e blerjes së kësaj pasurie deklaruar në deklaramtën “Vetting” është e saktë apo përgjigjja në pyetësorin e fundit se kjo pasuri është blerë në vlerën prej 70,000 euro është deklarim i pasaktë. Gjithashtu subjektit iu kërkua të provonte edhe burimin e ligjshëm për të gjithë shumën e blerjes së kësaj pasurie.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi: *“Sikurse kam sqaruar, vlera reale e blerjes së apartamentit është 70,000 euro, sikurse e kam deklaruar edhe në deklaramtat periodike që kam bërë ndër vite, ndërsa deklarimi në përmbajtje të deklaramtës “Vetting” tregon vlerën e pasqyruar në kontratë, duke i qëndruar strikt referimit në kontratë për vlerën prej 82,000 euro. Ndoshta do të duhej që sqarimet e nevojshme për vlerën reale të blerjes së apartamentit që janë dhënë në pyetësorin e datës 16.4.2019, të ishin paraqitur nga ana ime në mënyrë të detajuar që në plotësimin e deklaramtës “Vetting”. Kjo provohet nga statement bankar nga “Alpha Banka” të cilin e kam depozituar pranë jush në pyetësorin e fundit në datën 16.4.2019, ku rezulton tranferta e kryer në favor të familjes K. Prandaj, ritheksoj që nuk e kam disponuar asnjëherë shumën prej 12,000 eurosh dhe as kam paguar më shumë se 70,000 euro për blerjen e apartamentit”.*

Për këtë pasuri rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramta të ndryshme ndër vite.

Në deklaramtën periodike për vitin 2007 subjekti ka deklaruar: *“Blerje apartament banimi me sip. 85 m<sup>2</sup>, me vlerë 82,000 euro. Kredi për shtëpi në “Alpha Bank” me afat 20-vjeçar me interes 5 % për 5 vitet e para në shumën 70,000 euro, kësti mujor 500 euro. Kredia ka filluar në datën 3.10.2007”.*

Në deklaramtën periodike për vitin 2009 subjekti ka deklaruar: *“Apartament banimi me sip. 85 m<sup>2</sup>, me vlerë 70,000 euro”.*

Në deklaramtën periodike për vitin 2014 subjekti ka deklaruar: *“Blerje apartamenti me kredi tregtare në vlerën 70,000 euro. Kredia është blerë nga “BKT” në vlerën 8,600,000 lekë”.*

Në deklaramtën “Vetting” subjekti ka deklaruar: *“Apartament banimi në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe funksionale 85 m<sup>2</sup>. Vlera e deklaruar e apartamentit 82,000 euro. Kjo pasuri është blerë me kredi të marrë nga “Alpha Bank” në vlerën prej 70,000 eurosh, pasi banka mbulonte vetëm 70% të vlerës së blerjes së apartamentit. Kjo kredi është blerë nga “BKT”-ja në shtator të vitit 2012, në vlerën prej 8,600,000 lekësh, e cila përbëhet nga dy kredi: (1) njëra shtetërore në vlerën 5,000,000 lekë me interes fiks 4 %; dhe (2) tjetra kredi tregtare në vlerën 3,600,000 lekë me interes të ndryshueshëm”.*

**Në seancën dëgjimore të zhvilluar subjekti deklaroi se:** *“E gjithë procedura e ndjekur deri më tani nga Komisioni ka qenë korrekte. Ju falënderoj për këtë. Më është dhënë afati i duhur*

*për t'u njohur me provat, për të paraqitur observacionet e mia. Absolutisht edhe pyetja që ju keni parashtruar, janë ato çka edhe neve sikurse dihet, deklaratat e pasurisë janë konsoliduar pas vitit 2010 e mbrapa. Për disa vite bashkëshorti përkatës nuk ka qenë fare deklarues. Po ashtu e kemi kuptuar që kemi deklaruar për çka e kemi vetë, apo në bashkëpronësi, dhe nuk kemi deklaruar për ato çfarë kanë bashkëshortët.*

*Prandaj, unë i mbetem atyre çfarë kam thënë. Konfirmoj të gjitha gjetjet e Komisionit. Ju qëndroj atyre që unë kam thënë me shkrim për sa u takon lidhur me deklaratën Vetting të bashkëshortit tim për sa është plotësuar, si dhe dua të vë në dukje që ato gjetje kanë të bëjnë me periudhën para se të filloja në detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranës”.*

### **Arsyetimi ligjor**

*Lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit*

Në përputhje me Aneksin e Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe referuar praktikave të Kolegjit të Apelit, Komisioni, arrin në përfundimin se pasuritë e subjektit të rivlerësimit të deklaruar në deklaratën “Vetting”, i nënshtrohen kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, mbi saktësinë e deklaramit dhe mbi ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues. Në referim të kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, konstatohet se në asnjë prej dispozitave të këtij kuadri ligjor nuk parashikohet ndonjë normë juridike, sipas së cilës të vendosen kritere kufizuese vlerësimi, lidhur me pasuritë e subjekteve dhe personave të lidhur, me qëllim përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni arrin në konkluzionin se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme, apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj.

Konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të magjistratit në raport me ligjin, qoftë në formën e veprimeve të tij në kundërshtim me ligjin, apo edhe në formën e pranimi të veprimeve të personave të lidhur me të, cenon vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë të publiku në përmbushjen e misionit dhe rolit në dhënien e drejtësisë.

Komisioni krijoi bindjen se ligji kërkon kontrollin e plotë të pasurive të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, qofshin këto pasuri të krijuara para apo pas emërimit në detyrë si gjyqtare.

Hetimi i të gjitha pasurive të subjektit të rivlerësimit të deklaruar ose jo bëhet për të përjashtuar çdo mundësi që këto pasuri të jenë krijuar me anë të akteve korruptive gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, apo abuzimit të çdo forme të saj me detyrën apo nga veprimtari të tjera të kundërligjshme që cenojnë figurën dhe integritetin e gjyqtarit dhe e bëjnë atë të pabesueshëm në sytë e publikut, për sa kohë që sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se gjetjet janë për pasuritë e krijuara para periudhës së fillimit të detyrës si gjyqtare, Komisioni përveç faktit të përmendur se këto pasuri janë deklaruar nga subjekti në deklaratën vetting thekson se subjekti i rivlerësimit nga viti 2003

ka qënë subjekt deklarues për pasurinë pranë ILDKPKI-së dhe për rrjedhojë pasuritë e vëna gjatë kësaj periudhë janë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi.

#### *Lidhur me kredinë e butë të përfituar nga subjekti*

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredi të butë në “BKT” në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, i ndryshuar.

Procedura për dhënien e kredisë së butë është ndjekur nga institucionet shtetërore përkatëse dhe “BKT”-ja, të cilët kanë verifikuar dhe kushtet e përfitimit të kësaj kredie nga subjekti i rivlerësimit. Përfitimi i kredisë së butë është bërë pasi subjekti kishte përfituar kredi në kushtet e tregut nga “Alpha Bank” në vlerën prej 70,000 eurosh.

Marrja e kredisë së butë në vitin 2012, për shlyerjen e kredisë së tregut në “Alpha Bank” rezultoi se është bërë në përputhje dhe me Udhëzimin nr. 6257, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuar nga shteti”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 13/1, datë 8.9.2010, të Ministrit të Punëve Publike dhe Ministrit të Financave. Pika 22 e këtij udhëzimi përcakton se transferimi nga subjektet përfituese sipas këtij udhëzimi, i kredive të marra për strehim në banka të tjera përpara fillimit të këtij programi, mund të bëhet kur është praktikisht e realizueshme në marrëveshje midis bankës ku është marrë kredia dhe bankës që zbaton programin, vetëm në rastet kur familja plotëson kushtet sipas pikës 5 të këtij udhëzimi dhe kriteret e përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 600 datë, 12.9.2007.

#### *Lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie nga subjekti*

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të ndryshme ndër vite lidhur me vlerën për blerjen e kësaj pasurie në raport dhe me deklaratën “Vetting” dhe për të arritur në përfundim Komisioni analizoi çështjen si më poshtë.

Neni D i Aneksit të Kushtetutës “*vlerësimi i pasurive*” përcakton se subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet deklaramit dhe kontrollit të pasurive me qëllim identifikimin e pasurive në pronësi ose në përdorim, saktësimin e burimit të ligjshëm të pasurive, duke përfshirë dhe ato pasuri të cilat nuk i kanë deklaruar saktësisht ndër vite.

Në lidhje me procesin e vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30, të ligjit nr. 84/2016, objekt i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Ndërsa sipas pikës 5, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur deklarimet e interesave privatë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni. Bazuar në këto përcaktime kushtetuese dhe ligjore rezulton se deklaratat e pasurisë për procesin e rivlerësimit nuk është dokumenti i vetëm, i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit, por deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni.

Deklarata e pasurisë së rivlerësimit duhet të ketë të njëjtën përmbajtje me deklaratat periodike të pasurisë, me ndryshimin se në këtë deklaratë subjekti duhet të bëjë një pasqyrim të saktë, të të gjitha pasurive të akumuluar në vite. Kontrolli dhe krahasimi i deklarimeve të mëparshme me deklaratën e pasurisë, gjatë vlerësimit të pasurisë, është i domosdoshëm, pasi u shërben organeve të rivlerësimit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi mjaftueshmërinë e

deklarimeve të tij apo ligjshmërinë e të ardhurave të tij në vite, si dhe të burimeve të krijimit të pasurisë.

Në rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, vlerësimi i deklarimeve të mëparshme është i rëndësishëm, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri.

Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin më pas që deklaratën e pasurisë së rivlerësimit duhet ta plotësojë me saktësi të plotë. Ligji nr. 84/2016 synon realizimin e kontrollit të pasurisë së deklaruar në deklaratimet periodike dhe në deklaratën e rivlerësimit, si një kontroll të bazuar në deklaratimet në vazhdimësi të subjekteve të rivlerësimit.

Nëse deklaratata e pasurisë së rivlerësimit është hartuar me saktësi dhe vërtetësi, por në deklaratimet e mëparshme në lidhje me të njëjtën pasuri subjekti ka paraqitur deklarime të pasakta ose mosdeklarime, këto deklarime ose mosdeklarime të shkuara shërbejnë si provë për të përcaktuar përgjegjësinë e subjektit në raport me zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Për këtë arsye, pika 5, e nenit 32, e ligjit nr. 84/2016, u ka njohur vlerën e provës, deklaratave periodike të pasurisë. Sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, provat janë të dhëna që vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces. Në këtë kuptim, ligji nr. 84/2016, duke u dhënë deklaratave periodike të mëparshme të pasurisë vlerën e provës, i ka çmuar ato me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli. Këto deklarata së bashku me provat e tjera vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

Në analizë të provave të administruara Komisioni për këtë pasuri të deklaruar nga subjekti është mbështetur në parashikimet e nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të ndryshohet me pëlqimin e palëve ose për shkaqet e parashikuara me ligj”*.

Kontrata e përpiluar nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar.

Është konstatuar se subjekti me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 21.6.2007, ka blerë apartament në vlerën prej 82,000 eurosh. Paga sipas kontratës do të bëhej me dy këste. Kësti i parë do të paguhej në datën e lidhjes së kontratës, pra, më 21.6.2007, në shumën prej 7,000 eurosh dhe kësti i dytë prej 75,000 eurosh do të likuidohej deri më 30.7.2007, nëpërmjet një kredie bankare që do të merrej nga subjekti i rivlerësimit në “Alpha Bank”. Rezultoi se kredia në “Alpha Bank” është marrë në shumën 70,000 euro, veprim i cili është kryer nëpërmjet transaksioneve bankare.

Bazuar në këto përcaktime duke vlerësuar fuqinë detyruese të kontratës, në kushtet kur nuk rezulton e provuar që kjo kontratë të jetë ndryshuar nga palët, Komisioni arrin në përfundimin se shuma prej 82,000 eurosh, duhet të jetë paguar nga subjekti i rivlerësimit, ashtu siç është parashikuar dhe përcaktuar nga palët në kontratën e shitblerjes në datën 21.6.2007.

Lidhur me këtë pasuri, bazuar në kontratën e shitblerjes dhe veprimet për likuidimet e detyrimeve financiare, Komisioni përgatiti analizën financiare vjetore. Bazuar në analizën financiare për vitin 2007, kohë në të cilën është lidhur kontrata për blerjen e apartamentit dhe ka filluar pagimi i detyrimeve kontraktore, rezultoi se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën prej 796,928 lekë.

**Në përfundim konstatohet se:**

Nisur nga fakti se as në deklaratën “Vetting”, subjekti nuk ka plotësuar me saktësi dhe vërtetësi, edhe për shkak se në deklaratat periodike ka paraqitur deklarime të pasakta dhe të ndryshme, për Komisionin këto deklarime shërbejnë si provë për të përcaktuar përgjegjësinë e plotë të subjektit të rivlerësimit në raport me zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër trupi gjykues arsyeton se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, si bazuar në deklaratat periodike vjetore si në deklaratën “Vetting”, ka mospërputhje deklarimesh dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme.

Komisioni, bazuar te pikat 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, konstatoi se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi të saj.

❖ **Automjet, tip “Hyndai”**, prodhim i vitit 2007, me targë AA \*\*\* LG, në pronësi të bashkëshortit, z. A.H., blerë me *leasing* me kontratën nr. \*\*\*, datë 2.12.2015. Vlera e deklaruar: 20,000 euro. Pjesa takuese: 100 % (bashkëshorti i subjektit).

*Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”*

Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për vlerën e blerjes së këtij automjeti.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga DPPP-ja dhe DPSHTRR-ja.

DPSHTRR-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2018, ka dërguar të dhënat lidhur me automjetin në pronësi të bashkëshortit të subjektit me targë AA \*\*\* LG. Ky mjet rezulton i blerë nga bashkëshorti i subjektit me kontratën nr. \*\*\*, datë 2.12.2015, nga shoqëria “\*\*\*\*”.

Me qëllim vlerësimin e mundësisë financiare për blerjen e kësaj pasurie Komisioni shqyrtoi dokumentacionin e ndodhur në dosje, deklaratimet periodike të plotësuar nga subjekti ndër vite, dhe përgjigjet e pyetësorit të dërguar nga subjekti i rivlerësimit, për faktin se në deklaratën “Vetting” nuk është deklaruar burimi i ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie.

Subjekti për këtë pasuri pas pyetjeve të dërguara nga Komisioni ka deklaruar se: *“Në nëntor 2008 është lidhur kontrata për marrje me leasing të automjetit “Skoda” në vlerën 10,000 euro, nga të cilat 3,000 euro janë paguar si kapital fillestar. Në korrik 2010 bashkëshorti ka parapaguar kapitalin e mbetur prej 5,210 eurosh duke shlyer plotësisht vlerën e mjetit. Shuma prej 5,210 eurosh është financuar nga motra e bashkëshortit, e cila e ka marrë në përdorim mjetin. Në datën 31.7.2012, motra e bashkëshortit ka paguar shumën prej 3,000 eurosh, duke fituar pronësinë mbi këtë mjet. Në vitin 2010 ka lidhur kontratë leasing për automjetin “Hyndai” me vlerë 20,000 euro nga të cilat ka paguar fillimisht 9,000 euro dhe pjesën tjetër me këste”.*

Bazuar në deklarinimin e subjektit për të ardhurat e pretenduara në vlerën prej 5,210 eurosh, nga shitja e automjetit të mëparshëm, si burim financimi për blerjen e një pjese të automjetit, tip “Hyndai”, Komisioni zhvilloi një procedurë verifikuese hetimore.

Nga praktika e dërguar nga DPSHTRR-ja, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka pasur në pronësi një automjet, tip “Skoda”, me targë TR \*\*\* R, të cilin e ka shitur në vitin 2012. Për blerjen e këtij automjeti është marrë qira financiare dhe vlera e saj është deklaruar nga subjekti në shumën 7.000 euro + interesat.

Blerja e automjetit tip “Skoda” në datën 13.11.2008 dhe lidhja e qirasë financiare me shoqërinë “\*\*\*\*” nuk është deklaruar nga ana e subjektit në deklaratën vjetore periodike për vitin 2008 dhe as në deklaratën periodike për vitin 2012, kohë kur është shitur kjo pasuri e luajtshme me

anë të kontratës së shitjes të hartuar pranë noterit publik. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti vetëm në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010.

Komisioni konstatoi se në deklaratat periodike për vitin 2010 dhe 2012 nuk rezultojnë të jenë deklaruar të ardhura të krijuara nga shitja e automjetit, tip “Skoda”, në pronësi të bashkëshortit së subjektit të rivlerësimit.

Komisioni në analizën financiare ka marrë parasysh vetëm deklaratimet e subjektit lidhur me të ardhurat për shitjen e automjetit bazuar në kontratën e shitblerjes në vlerën prej 3,000 eurosh, pasi deklarimi i subjektit për fitimin e vlerës prej 5,210 eurosh në vitin 2010 nuk është provuar. Deklarimet e tjera për mënyrën e financimit të këtij mjeti nuk dokumentohen nga dokumente shkresore provuese të kohës dhe as nga deklaratimet në deklaratat periodike vjetore të kohës. Vlerat e shpenzuara për blerjen e automjetit tip “Skoda” (përveç vlerës 3,000 euro) janë llogaritur si shpenzime të kryera nga subjekti në vitet përkatëse.

Për këto gjetje të Komisionit subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumente dhe prova, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi: *“Sikurse kam deklaruar, automjeti tip “Skoda” është blerë nga motra e bashkëshortit, znj. D.H., e cila ka parapaguar vlerën prej 5,210 eurosh dhe pastaj është paguar si këst i dytë edhe vlera 3,000 euro. Duke mos qenë në dijeni të këtij fakti (për shkak se ka qenë një veprim i kryer në kuadrin e një marrëdhënieje të ngushtë familjare midis vëllait dhe motrës, në të cilën unë nuk jam përzier), unë nuk e kam deklaruar në deklaratat periodike. Sqaroj se motra e bashkëshortit ka pasur mundësinë për blerjen e automjetit tip “Skoda”, për arsye se në momentin e kësaj pagese ajo ka pasur kursimet e një periudhe 5-vjeçare nga puna si ekonomiste dhe se për shkak të statusit civil si beqare dhe jetesës me prindërit e saj, nuk ka pasur detyrime të tjera financiare apo shpenzime të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim, paraqes dokumentacion provues lidhur me mundësitë financiare të saj”.*

### **Arsyetimi ligjor**

Arsyetimi ligjor nga Komisioni lidhur me këtë pasuri është i njëjtë me arsyetimin ligjor të bërë për këtë subjekt rivlerësimi lidhur me pasurinë apartament ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.

Procesi i vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30, të ligjit nr. 84/2016, ka të bëjë me deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Ndërsa sipas pikës 5, të nenit 32, të ligjit të lartpërmendur deklarimet e interesave privatë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni.

Bazuar në këto përcaktime kushtetuese dhe ligjore rezultojnë se deklaratat e pasurisë për procesin e rivlerësimit nuk është dokumenti i vetëm, i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit, aq më tepër as deklarimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit, por deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni. Për këtë arsye, pika 5, e nenit 32, e ligjit nr. 84/2016, u ka njohur vlerën e provës, deklaratave periodike të pasurisë. Sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile provat janë të dhëna të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces. Në këtë kuptim, ligji nr. 84/2016, duke u dhënë deklaratave të mëparshme të pasurisë vlerën e provës, i ka çmuar ato me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

Siç është përcaktuar dhe konstatuar më lart nga Komisioni, pasuria automjet tip “Skoda” nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në periudhën e blerjes së kësaj pasurie, pra, në deklaratën periodike për vitin 2008. Kjo pasuri nuk është deklaruar as në deklaratën periodike për vitin 2012, kur ajo është shitur.

Bazuar në kontratën e shitjes pranë noteres V. S. në datën 31.7.2012, rezultoi se automjeti tip “Skoda” është shitur nga subjekti i rivlerësimit në shumën prej 3,000 eurosh, shumë e cila është marrë për bazë në vlerësimin ligjor dhe financiar të kryer dhe të përfunduar nga Komisioni për këtë pasuri.

Komisioni, në analizë të provave të administruara është mbështetur dhe në parashikimet e nenit 690 të Kodit Civil, në të cilin përcaktohet se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të ndryshohet me pëlqimin e palëve ose për shkaqet e parashikuara me ligj”*.

Kontrata e përpiluar nga nëpunësi i shtetit ose nga personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaramëve që janë bërë përpara tyre, për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar.

Bazuar në këto përcaktime, duke vlerësuar fuqinë detyruese të kontratës, në kushtet kur nuk rezulton e provuar që kjo kontratë të jetë ndryshuar nga palët, Komisioni arrin në përfundimin se vetëm kjo shumë prej 3,000 eurosh konsiderohet si e ardhur e ligjshme, e cila është marrë në konsideratë nga Komisioni.

Lidhur me likuidimet e detyrimeve financiare për këtë pasuri, bazuar në kontratën e shitblerjes, Komisioni përgatiti analizën financiare vjetore. Bazuar në analizën financiare për vitin 2010, në kohën kur pretendohet përfitimi i shumës prej 5,210 eurosh nga shitja e automjetit “Skoda”, rezultoi se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën prej -970,609 lekë.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Për sa më sipër trupi gjykues arsyeton se subjekti nuk ka deklaruar burimin e financimit për pasurinë automjet “Hyundai” në deklaratën “Vetting”.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, nuk arriti të provojë të ardhurat e ligjshme nga shitja e automjetit, tip “Skoda”, e cila është pretenduar si burim për blerjen e automjetit “Hyundai”.

Deklarimet e subjektit nuk përputhen me deklaratat periodike vjetore dhe me deklaratën “Vetting”, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për periudhën e vitit 2010, në kohën e blerjes së automjetit tip “Hyundai”.

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në përputhje me pikat 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, është munduar dhe përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë të ardhurat e përfituara për pasurinë në pronësi të saj.

- ❖ **Automjet, tip “A Class 180”,** në përdorim, prodhim i vitit 2005, me pronar shtetasin A.D., (djali i tezes së subjektit), vlera 700,000 lekë.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja, pasi mjete është në pronësi të shtetasit A. D., dhe është deklaruar në përdorim nga subjekti.

Sipas hetimit të kryer nga Komisioni rezultoi se ky automjet është blerë nga shtetasi A. D., me kontratën e datës 10.7.2012, me vlerën 700,000 lekë.

Subjektit i është kërkuar të vërë në dispozicion dokumentacion lidhur me aktin e përdorimit, me konfirmimin e pronarit si i afërm i subjektit, si dhe me burimin e ligjshëm dhe me mundësitë financiare për blerjen e kësaj pasurie nga personi huadhënës.

Në përgjigje të pyetësorit 2, subjekti ka deklaruar: *“Ka dy vjet e gjysmë që s’e kam përdorur automjetin tip “A Class” dhe nuk disponoj dokumentin e vjetër për përdorimin e makinës. Dokumentet provuese për deklarimet e djalit të tezes gjenden bashkëlidhur përgjigjes për pyetësorin 2”*.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni, pas verifikimit të provave të paraqitura nga subjekti dhe burimeve të ligjshme të shtetasit A.D., në rolin e huadhënësit të mjetit në përdorim, arriti në përfundimin se për këtë pasuri të deklaruar në përdorim nga subjekti nuk janë konstatuar problematika.

- ❖ **Llogari bankare në “BKT” si person fizik, në emër të bashkëshortit. Vlera: 44,130 lekë.**

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**Konstatim i ILDKPKI-së:** Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga “BKT”-ja.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni, bazuar në konfirmimin e “BKT”-së, konstatoi se subjekti ka bërë deklarim të saktë të vlerës për këtë llogari bankare.

- ❖ **Kontratë kredie (2 kontrata) në “BKT”, me afat 20-vjeçar, për blerjen e apartamentit, të lëvruara në datën 10.9.2012, në shumën prej 3,600,000 lekë (kredi tregtare me interes të ndryshueshëm) dhe në shumën prej 5,000,000 lekë (kredi shtetërore me interes fiks 4 %).**
  - Nga kredia e parë, në vlerën prej 3,600,000 lekë, ka mbetur pa u shlyer shuma 3,113,290 lekë.
  - Nga kredia e dytë, në vlerën prej 5,000,000 lekë, ka mbetur pa u shlyer shuma 4,512,924 lekë.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga “BKT”-ja.

Analiza për këto kontrata kredie, të dhënat përkatëse, veprimet bankare, si dhe gjendja e likuiditeteve janë trajtuar nga Komisioni si më poshtë në analizën financiare, të ndarë sipas veprimeve të kryera nga subjekti dhe bashkëshorti për vitet përkatëse.

- ❖ **Overdraft në “BKT”, që nga viti 2012; detyrimi i mbetur në vlerën: 172,000 lekë.**

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga “BKT”-ja.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni, pas konfirmimit të “BKT”-së, konstatoi se subjekti ka bërë deklarim të saktë të vlerës së *overdraftit*.



- ❖ **Kartë krediti “Prima Card”** nga “BKT”-ja, në emër të bashkëshortit, me vlerë të miratuar 100,000 lekë.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga “BKT”-ja.

**Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni, pas konfirmimit të “BKT”-së, konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë të vlerës së kartës së kreditit.

- ❖ **Lidhur me çështjen e qirasë së subjektit të rivlerësimit**

Gjatë hetimit administrativ Komisioni konstatoi se subjekti ka blerë pasuri të paluajtshme, apartament në vitin 2007 në Tiranë, por se nuk përcaktohej se ku kishte jetuar për periudhën 2003 – 2007. Subjektit i është kërkuar përmes pyetësorit 2 që të sqaronte se ku kishte jetuar gjatë kësaj periudhe dhe sa kishte qenë vlera e shpenzimeve të kryera.

Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se për periudhën 2003 – 2007 kishte jetuar në shtëpi me qira në Rr. “\*\*\*\*”, për të cilën ka paguar qira fikse në vlerën prej 25,000 lekë në muaj. Gjithashtu, subjekti deklaroi se nuk ka pasur kontratë të shkruar, por bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit është paraqitur si provë deklarata e bërë nga pronarja e këtij apartamenti, A. D.

Shpenzimet e qirasë në vlerën prej 25,000 lekësh në muaj janë përfshirë në analizën financiare për periudhën 2003 – 2007.

Komisioni, në rezultatet e hetimit, konstatoi se mungon kontrata e qirasë dhe dokumentacioni provues për pagimin e detyrimeve tatimore që lindin nga kontrata e qirasë.

Për këtë çështje subjektit të rivlerësimit iu kërkuar sqarime.

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi: *“Sikurse kam sqaruar, me znj. A. D., kemi pasur një marrëdhënie mirëbesimi. Kontrata e qirasë ka qenë e lidhur në mënyrë verbale dhe detyrimet i kemi shlyer rregullisht, sikurse është paraqitur edhe në deklaratën e firmosur prej saj. Duke qenë se detyrimet tatimore aplikohen sipas parimit të vjeljes nga qiradhënësi të detyrimit fiskal mbi të ardhurat, që ky i fundit përfiton nga qiraja, unë nuk kam ndonjë informacion të mëtejshëm lidhur me këtë aspekt”.*

**Në përfundim konstatohet se:**

Detyrimi ligjor lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore është i subjektit qiradhënës dhe rezultoi se subjekti në këto raste nuk ka përgjegjësi.

**Vlerësimi dhe analiza financiare**

VITI	Të ardhura	Pasuria	Detyrime	Pasuria neto	Shpenzime	Rezultati
2003	1,073,754	0	0	0	487,928	585,826
2004	1,748,711	0	0	0	581,892	1,166,819
2005	2,376,265	-1,004	0	-1,004	628,671	1,748,598
2006	1,506,405	287,063	0	287,063	709,078	510,264
2007	1,959,222	9,644,284	8,403,858	1,240,426	1,515,724	- 796,928
2008	2,349,016	1,521,126	614,314	906,812	1,148,108	294,097
2009	2,860,315	-404,268	-446,450	42,182	1,298,604	1,519,529
2010	2,717,748	2,786,011	347,280	2,438,731	1,249,626	- 970,609

2011	2,047,267	591,507	-289,263	880,769	1,349,860	- 183,362
2012	3,729,251	-1,414,272	-565,499	-848,773	2,235,234	2,342,790
2013	2,910,987	265,405	-292,429	557,834	1,148,032	1,205,120
2014	1,638,856	-326,744	-685,049	358,304	1,386,561	- 106,009
2015	1,987,506	-110,590	-556,785	446,195	1,682,410	- 101,180
2016	2,963,447	69,708	-242,180	311,888	1,592,195	1,059,364

Komisioni konstatoi se në disa vjet subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamundësi likuiditetesh. Në hartimin e analizës financiare nga Komisioni nuk janë marrë parasysh deklaratimet e bëra nga subjekti për fitimin e shumës prej 8,000 eurosh në vitin 2010 nga bashkëshorti i saj, si dhurim i prindërve, dhe as burimin për fitimin e shumës prej 5,210 eurosh, financuar nga e motra e bashkëshortit për blerjen e automjetit tip “Skoda”.

Këto vlera financiare nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni për shkak se nuk bazohen në dokumentacion shkresor provues të kohës, as në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën “Vetting” të plotësuar nga subjekti.

<b>PËRSHKRIMI</b>		<b>Viti 2007</b>
<b>I.</b>	<b>PASURI</b>	<b>9,644,284</b>
	Apartament me sip. 85 m <sup>2</sup> 2+1, Rr. “***”,*** (1/2 ), viti 2007, vlera 82.000 euro	9,914,620
	Diferencë likuiditeti (likuiditeti datë 31.12.2007 - likuiditeti datë 31.12.2006 )	-270,336
<b>II.</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>8,403,858</b>
	Kredi “Alpha Bank”, viti 2007, vlera 70.000 euro (kësti 495 euro)	8,403,858
<b>III.</b>	<b>PASURI NETO (I - II)</b>	<b>1,240,426</b>
<b>IV.</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>1,959,222</b>
	Të ardhura, subjekti Enkeledi Hajro	1,057,809
	Të ardhura, bashkëshorti A.H.	901,413
<b>V.</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1,515,724</b>
	Shpenzime jetese	546,480
	Shpenzime qiraje, viti 2007, për banim vlera 25,000 lekë/muaj	225,000
	Shpenzime udhëtimi	168,065
	Shpenzime arredimi për shtëpinë	450,000
	Shpenzime interesa për kredinë në “Alpha Bank” në vlerën 70,000 euro (1.044 euro)	126,179
<b>VI.</b>	<b>REZULTATI (IV - III - V)</b>	<b>-796,928</b>

Komisioni konstatoi se për vitin 2007 subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej 796,928 lekësh.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka deklaruar se mungesa e burimeve financiare ka ardhur për shkak të diferencës prej 12,000 eurosh, e cila rezulton nga kontrata e shitjes me rezervë e apartamentit. Subjekti deklaroi se nuk e ka disponuar asnjëherë shumën prej 12,000 eurosh dhe insistoi se vlera reale e blerjes së apartamentin në këtë vit ka qenë 70,000 euro.

Lidhur me këtë, Komisioni është shprehur në analizën e bërë më sipër për pasurinë apartament të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë.

<b>PËRSHKRIMI</b>		<b>Viti 2010</b>
<b>I</b>	<b>PASURI</b>	<b>2,786,011</b>
	Automjet “Hyundai”, AA *** LG, A. H., blerë me <i>leasing</i> në “****”, viti 2010, vlera 20,000 euro	2,776,200
	Diferencë likuiditeti (likuiditeti datë 31.12.2010 - likuiditeti datë 31.12.2009)	9,811
<b>II</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>347,280</b>
	Kredi “Alpha Bank”, viti 2007, vlera 70.000 euro (kësti 2.182 euro)	-302,842
	Kontratë <i>leasing</i> , viti 2010, për automjet “Hunday”, vlera 20,000 euro (kësti 9.604 euro)	1,442,956
	Kontratë <i>leasing</i> , viti 2008, për automjet “Skoda”, vlera 10,000 euro (kësti 5.711 euro)	-792,834
<b>III</b>	<b>PASURI NETO (I - II)</b>	<b>2,438,731</b>
<b>IV</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>2,717,748</b>
	Të ardhura, subjekti Enkeledi Hajro	1,578,244
	Të ardhura nga shitja e automjetit “Benz 190”, A.H.	350,000
	Të ardhura, bashkëshorti A.H.	789,504
<b>V</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1,249,626</b>
	Shpenzime jetese	546,480
	Shpenzime interesi <i>leasing</i> për autobjetin tip “Skoda” (306 euro)	42,504
	Shpenzime interesi <i>leasing</i> për autobjetin tip “Hunday” (344.7 euro)	47,859
	Shpenzime udhëtimi	65,241
	Shpenzime arredimi për shtëpinë	30,000
	Shpenzime interesa për kredinë në “Alpha Bank”, 70,000 euro (3.728 euro)	517,542
<b>VI</b>	<b>REZULTATI (IV - III - V)</b>	<b>-970,609</b>

Komisioni konstatoi se për vitin 2010 subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej 970,609 lekësh.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka deklaruar se mungesa e burimeve financiare ka ardhur për shkak të mosnjohjes nga Komisioni të dhurimit të bërë bashkëshortit nga babai i tij në vitin 2010 të shumës prej 8,000 eurosh.

Këtë deklaram të subjekti Komisioni nuk e mori në konsideratë, për shkak se është bërë nga subjekti për të shmangur përgjegjësinë dhe mosarsyetimin e mungesës së burimeve financiare të ligjshme. Të ardhurat e pretenduara të përfituara në vitin 2010 nuk u provuan nga subjekti.

Komisioni konstatoi se vlera e pretenduar si e ardhur në shumën prej 8,000 eurosh nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike për vitin 2010, as në deklaratën “Vetting”, si dhe nuk bazohet në ndonjë dokumentacion ligjor në kohën e përfitimit siç u pretendua nga subjekti.

	<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>Viti 2011</b>
<b>I</b>	<b>PASURI</b>	<b>591,507</b>
	Diferencë likuiditeti (likuiditeti datë 31.12.2011 – likuiditeti datë 31.12.2010)	591,507
<b>II</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>-289,263</b>
	Kredi “Alpha Bank”, viti 2007, vlera 70.000 euro (kësti 2.045 euro)	-282,764
	Kontrate <i>leasing</i> , viti 2010 për automjetet “Hunday”, vlera 20,000 euro (kësti 1.914 euro)	-264,696
	Kredi “Raiffeisen Bank”, viti 2011, vlera 450,000 lekë	258,198
<b>III</b>	<b>PASURI NETO (I - II)</b>	<b>880,769</b>
<b>IV</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>2,047,267</b>
	Të ardhura, subjekti Enkeledi Hajro	1,547,173
	Të ardhura, bashkëshorti A.H.	500,094
<b>V</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1,349,860</b>
	Shpenzime jetese	546,480
	Shpenzime interesi <i>leasing</i> për automjetin tip “Hunday” (915 euro)	126,536
	Shpenzime interesi kredi “Raiffeisen Bank”, 450,000 lekë	45,890
	Shpenzime udhëtimi	13,830
	Shpenzime arredimi për shtëpinë	40,000
	Shpenzime interesa për kredinë 70,000 euro (4.173 euro)	577,123
<b>VI</b>	<b>REZULTATI (IV - III - V)</b>	<b>-183,362</b>

Komisioni konstatoi se për vitin 2011 subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej 183,362 lekësh. Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti pretendoi se gjatë këtij viti ka qenë dy herë jashtë vendit për arsye pune dhe se këto shpenzime nuk duhet të llogariten si shpenzime të subjektit.

Komisioni, në vlerësim përfundimtar të analizës financiare, pas paraqitjes së provave nga subjekti i rivlerësimit, nuk i ka llogaritur këto dy udhëtime si shpenzime të kryera prej tij.

PËRSHKRIMI		Viti 2014
<b>I</b>	<b>PASURI</b>	<b>-326,744</b>
	Diferencë likuiditeti (likuiditeti datë 31.12.2014 - likuiditeti datë 31.12.2013)	-326,744
<b>II</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>-685,049</b>
	Kontratë <i>leasing</i> , viti 2010, për automjet “Hunday”, vlera 20,000 euro (kësti 2.431 euro)	-340,630
	Kredi në “BKT”, viti 2012, në vlerën 8,600,000 lekë	-221,647
	Kredi në “Union Bank”, viti 2013, A.H., e padeklaruar 250,000 lekë	-122,771
<b>III</b>	<b>PASURI NETO (I - II)</b>	<b>358,304</b>
<b>IV</b>	<b>TE ARDHURA</b>	<b>1,638,856</b>
	Të ardhura, subjekti Enkeledi Hajro	973,840
	Të ardhura, bashkëshorti A.H.	665,016
<b>V</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1,386,561</b>
	Shpenzime jetese	879,992
	Shpenzime interesi “BKT” për kredi, 8,6 milionë	384,641
	Shpenzime interesi <i>leasing</i> për automjetin tip “Hunday” (294 euro)	41,234
	Shpenzime interesi kredi, “Union Bank”, A.H., vlera 250,000 lekë	27,452
	Shpenzime udhëtimi	53,242
<b>VI</b>	<b>REZULTATI (IV - III - V)</b>	<b>-106,009</b>

Komisioni konstatoi se për vitin 2014 subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej 106,009 lekësh.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka deklaruar se mungesa e burimeve financiare ka ardhur për shkak se nga Komisioni këtë vit nuk janë përfshirë të ardhurat si tepricë e vitit 2013. Komisioni konstaton se mënyra e hartimit dhe e konceptimit të analizës financiare është e njëjtë për të gjithë subjektet. Provueshmëria e deklarimeve të subjekteve bazohet në deklaratat periodike vjetore që janë bërë nga vetë subjektet e rivlerësimit. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore ndryshimin e likuiditeteve dhe mbartjen e tyre për vitin pasues.

PËRSHKRIMI

Viti 2015

<b>I</b>	<b>PASURI</b>	<b>-110,590</b>
	Diferencë likuiditeti (likuiditeti datë 31.12.2015 - likuiditeti 31.12.2014)	-110,590
<b>II</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>-556,785</b>
	Kontratë <i>leasing</i> , 2010, për automjet “Hunday”, vlera 20,000 euro (kësti 1.731 euro)	-238,338
	Kredi në “BKT”, viti 2012, vlera 8,600,000 lekë	-235,910
	Kredi në “Union Bank”, viti 2013, A. H., vlera 250,000 lekë	-82,537
<b>III</b>	<b>PASURI NETO (I - II)</b>	<b>446,195</b>
<b>IV</b>	<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1,987,506</b>
	Të ardhura, subjekti Enkeledi Hajro	1,179,029
	Të ardhura, bashkëshorti A. H.	808,477
<b>V</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1,642,492</b>
	Shpenzime jetese	897,104
	Shpenzime interesi “BKT” për kredi, vlera 8,6 milionë lekë	357,221
	Shpenzime interesi <i>leasing</i> , për autobjetin tip “Hunday” (63 euro)	8,665
	Shpenzime interesi kredi “Union Bank”, A. Hajro, 250,000 lekë	5,094
	Shpenzime udhëtimi	374,408
<b>VI</b>	<b>REZULTATI (IV - III - V)</b>	<b>-101.180</b>

Komisioni konstatoi se për vitin 2015 subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej 141,099 lekësh.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka deklaruar se mungesa e burimeve financiare ka ardhur për shkak të llogaritjes nga Komisioni të shpenzimeve lidhur me dy udhëtime jashtë vendit.

Komisioni, pas përgjigjeve të rezultateve të hetimit të bëra nga subjekti, i mori këto shpjegime në konsideratë dhe i reflektoi ato në analizën financiare. Gjithsesi, subjekti rezultoi në mungesë të burimeve financiare për vitin 2015 në vlerën 101,180 lekë.

Komisioni konstatoi se në total për vitet 2007, 2010, 2011, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në total në shumën prej 2,158,088 lekësh.

#### ❖ Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë hartimit të analizës financiare për subjektin, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, të subjektit dhe të personave të lidhur, gjendje të vërtetuara nga dokumentet bankare: “Credins Bank”, “Intesa

Sanpaolo Bank”, “Raiffeisen Bank”, “ProCredit Bank”, “BKT”, “Alpha Bank” dhe “Union Bank”.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: Shkollën e Magjistraturës për periudhën 1997 – 1999, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën 2000 – 2003, në Gjykatën e Lartë si ndihmëse ligjore për periudhën 2003 – 2006, në Ministrinë e Drejtësisë për periudhën 2006 – 2008, në Avokaturën e Shtetit për periudhën 2009 – 2011, në Ministrinë e Punëve të Brendshme për periudhën 2012 – 2013, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore (pagesë kalimtare) në vitet 2013 – 2014, në Universitetin \*\*\* në vitet 2009 dhe 2012, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 2014 – 2016, në Dhomën Kombëtare të Avokatisë në vitin 2012, në Institutin e Ekspertëve Kontabël në vitin 2012, në komisione dhe në borde të ndryshme si anëtare në vitet 2006, 2008, 2011 dhe 2012, si dhe shpërblimi si ish e përndjekur në vitet 2009 dhe 2013.

ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit: në Drejtorinë e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për periudhën 1999 – 2003, në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t për periudhën 2006 – 2010, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë për periudhën 2012 – 2013, në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (INUK) për periudhën 2010 – 2011, prej aktivitetit si noter për periudhën 2013 – 2016, prej aktivitetit privat bar-kafe në vitet 2003 – 2005, dhe të ardhurat e ndryshme për periudhën 2011 – 2013.

iii) Të ardhurat nga shitja e automjetit, tip “Mercedes Benz”, në vitin 2010, si dhe nga shitja e automjetit, tip “Skoda” në vitin 2012.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës, bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i).

ii) Shpenzime udhëtimi, për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Në rastet kur ka informacion për destinacionet e largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur duke parë në internet çmimet mesatare të destinacionit përkatës. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi.

Gjithashtu, nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar tek të afërmit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti kanë deklaruar dhe kanë dokumentuar udhëtime për qëllime pune.

Konkretisht janë marrë parasysh në analizën financiare shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit si më poshtë:

- Subjekti deklaroi si përgjigje ndaj rezultateve të hetimit, se në datën 27.7.2015 dhe datën 7.8.2015 ka qëndruar tek të njohurit e saj dhe nuk ka pasur shpenzime akomodimi dhe ushqimi. Shpenzimet e tjera nuk e kalojnë vlerën 600 euro.
- Subjekti deklaroi se në datën 10.8.2015 dhe në datën 18.8.2015 ka qëndruar në resort turistik me akomodim *all inclusive*, me kosto 1.700 euro.
- Subjekti deklaroi se në datën 28.11.2015 dhe në datën 30.11.2015 ka bërë një udhëtim me shpenzime jo më shumë se 300 euro, në Kotor, Mal i Zi.
- Subjekti deklaroi se në datën 12.12.2015 ka bërë një udhëtim me shpenzime që nuk i kalon 120 eurot, në Podgoricë, Mal i Zi

Përfundimisht, me ndryshimet e pretenduara nga subjekti, lidhur me shpenzimet e udhëtimit në vitin 2015, vlera e këtyre shpenzimeve ndryshoi nga 3.010 euro (sipas Komisionit) në 2.720 euro (sipas subjektit). Ky ndryshim u reflektua në tabelën e rezultatit financiar të vitit 2015.

iii) Shpenzime arredimi, arsimim fëmijësh dhe shpenzime mjekësore të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga Komisioni.

iv) Shpenzime interesa dhe *principal* për shlyerjen e kredive financiare me “Alpha Bank”, “BKT”, “Union Bank”, “Raiffeisen Bank”, si dhe shpenzime interesa dhe *principal* për qiranë financiare me “\*\*\*” sh.a.

v) Shpenzime qiraje të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit te pyetësorët.

vi) Shpenzime të bëra për konsum familjar të deklaruara në pyetësor.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive.

## **B. NË LIDHJE ME KONTROLLIN E FIGURËS**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë 26.12.2018, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: **“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro”**.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

## **C. NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE**

Raporti për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, në detyrën e gjyqtarës/kryetarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është hartuar në përputhje me Kreun VI, të ligjit nr. 84/2016. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) Pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Raporti është kontrolluar dhe vlerësuar nga relatori i çështjes i cili ka paraqitur përpara trupit gjykues të Komisionit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro.

## **GJETJET NGA PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE GJYQËSORE PËR GJYQTAREN ENKELEDI HAJRO TË PËRZGJEDHURA ME SHORT**



Nga pesë dosjet e përzgjedhura me short rezultuan disa problematika në tre dosje për të cilat nga Komisioni iu kërkuan shpjegime subjektit me dërgimin e rezultateve të hetimit.

- ❖ **Dosja 1.** Çështja penale nr. \*\*\* regj, datë 15.2.2016, regjistrim që i përket të pandehurit B.K., akuzuar për veprën penale të vetëgjyqësisë të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.5.2016.

Dosja gjyqësore dhe vendimi i përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 30.5.2016, 13 ditë nga shpallja, pra, jashtë afatit 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 3 muaj e 2 ditë, në intervalin kohor 16.02.2016 – 18.05.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga shkronja “a”, pika 5, e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht është respektuar standardi për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Janë caktuar 5 seanca gjyqësore nga cilat 2 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 3 seanca joproductive (*shih* seancat 1, 2 e 3) ka qenë njoftimi i të pandehurit (1 seancë) dhe paraqitja e mbrojtëses e papërgatitur në gjykim (2 seanca). Në caktimin e seancave gjyqësore janë respektuar afatet ligjore, me përjashtim të seancës 4, që është caktuar në tejkalim të afatit 15 ditor të përcaktuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale. Janë mbikëqyrur aktet e njoftimit pa pasur vonesa në kryerjen e tyre dhe nuk ka pasur asnjë seancë të dështuar për shkak të njoftimeve. Në çeljen e seancave nuk ka pasur vonesa, me përjashtim të seancës 5, e cila ka filluar me 5 minuta vonesë për shkak të zgjatjes së gjyqit të orës 13:00 deri në orën 13:20. Vendi i zhvillimit të seancës (sallë apo zyrë) nuk është dokumentuar.

Lidhur me këto konstatime subjekti paraqiti shpjegime në përgjigje të rezultateve të hetimit. Komisioni, pas përgjigjeve të sjella nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezultoi të ketë indice apo prova për paafësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

- ❖ **Dosja 2.** Çështja civile nr. \*\*\* regj, datë 11.3.2015, regjistrim që i përket, i dëmtuar akuzues G.Ç., e akuzuar Sh.A., akuzat: “*Shpifje, parashikuar nga neni 120 i Kodit Penal*”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.5.2016.

Dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 18.5.2016, 13 ditë nga shpallja, pra, jashtë afatit 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 vit e 1 muaj e 25 ditë, në intervalin kohor 11.03.2015 – 06.05.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard 4-mujor të përcaktuar nga shkronja “a”, pika 5, e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Janë caktuar 22 seanca gjyqësore, nga cilat 6 seanca pajtimore dhe 16 seanca gjyqësore, nga të cilat 7 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 15 seanca joproductive kanë qenë njoftimi i të akuzuarës (5 seanca), mungesa e mbrojtësit të zgjedhur (2 seanca), mungesa e prokurorit (5 seanca), mungesa e të dëmtuarit akuzues (2 seanca), mungesa e gjyqtarës (1 seancë). Caktimi i 8 seancave është në tejkalim të afatit 15 ditor të përcaktuar nga neni 342/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku në 5 raste tejkalimi është me 2-3 ditë. Ndërsa në 3 raste, ky tejkalim ka qenë domethënës, gjyqtarja në vendimin e ndërmjetëm ka dhënë shkaqet e tejkalimit të afatit të lidhura me lejen vjetore, festat zyrtare apo pjesëmarrjen në trajnim (*shihni* seancat 5, 12 dhe 17). Janë konstatuar 5 seanca gjyqësore të dështuara për shkak të njoftimit të së akuzuarës, megjithatë gjyqtarja ka mbikëqyrur aktet e njoftimit, pasi e akuzuara rezultonte e larguar jashtë shtetit. Në çeljen e seancave ka pasur vonesa nga 4 – 20 minuta (*shihni* seancat 6, 7, 8, 9, 10 dhe 13) dhe shkak nuk është dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, por nuk ka sjellë pasoja në zhvillimin e seancës. Nga vëzhgimi i seancave rezultoi se 1 seancë pajtimore

dhe 5 seanca gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjykimi me regjistrim audio (*shihni* seancat 6-10 e 13). Për sa i takon veprimeve procedurale në gjykim, konstatohet se në 2 seanca gjyqësore, gjyqtarja ka proceduar njëherazi me pjesëmarrjen e mbrojtësit të zgjedhur dhe të mbrojtësit të caktuar kryesisht (*shih* seancat 11 dhe 12).

Lidhur me këto konstatime subjekti paraqiti shpjegime në përgjigje të rezultateve të hetimit. Komisioni pas përgjigjeve të sjella nga subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

- ❖ **Dosja 3.** Çështja penale nr. \*\*\* regj, datë 20.2.2015, regjistrim që i përket të pandehurit F.D., i akuzuar për: “ *Dhunë në familje, parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal*”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.4.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 20.2.2015 dhe me shortin e datës 23.2.2015 i është caktuar subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro.

Dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 6.5.2015, 13 ditë nga shpallja, pra, jashtë afatit 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Lidhur me këto konstatime subjekti paraqiti shpjegime në përgjigje të rezultateve të hetimit. Komisioni pas përgjigjeve të sjella nga subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

## **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË**

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale u konstatua se gjyqtarja Enkeledi Hajro ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 30.7.1997 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2000. Në datën 27.9.2000 ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në datën 31.7.2003 largohet nga sistemi gjyqësor me kërkesën e saj. Në vijim në datën 10.7.2014, ajo dekretohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në datën 18.11.2016 emërohet kryetare e kësaj gjykate, detyrë të cilën e vazhdon dhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultoi se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Enkeledi Hajro janë paraqitur gjithsej 2 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (1 ankesë në vitin 2014 dhe 1 ankesë në vitin 2015). Ankesa e vitit 2015 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe ankesa e vitit 2014 e verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal ligji, në përfundim është arkivuar pasi pretendimet rezultuan të pabazuara.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Enkeledi Hajro përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

## **ANALIZA E GJETJEVE**

### **1. Aftësitë profesionale**

#### **a) Njohuritë ligjore**

Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, është magjistrate e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës. Ajo ka aftësitë e duhura në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Tre dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën procedurale penale.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve.

## 2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, ka përfunduar 570 çështje, nga të cilat 407 çështje penale themeli, 17 çështje penale themeli me të dëmtuar akuzues, 142 çështje administrativo-penale dhe 4 masa sigurimi.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës pajtimore apo gjyqësore. Ajo i kushton shumë rëndësi kërkimeve procedurale të palëve dhe në ndonjë rast, tejkalon edhe detyrimin ligjor, në funksion të garantimit të pjesëmarrjes së plotë të palëve në proces dhe të dëgjimit të pretendimeve të tyre.

## 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Enkeledi Hajro (*shihni* të dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së). Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro. Për vetë gjyqtaren Enkeledi Hajro në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

## 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Enkeledi Hajro komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 12 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

## **NË LIDHJE ME DENONCIMET**

Në Komision janë paraqitur 8 denoncime të publikut për subjektin e rivlerësimit si më poshtë:

1. Denoncim i shtetases V.O., me nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2017, e cila e denoncon subjektin për zvarritje të procesit dhe për vendim të padrejtë.
2. Denoncim i shtetases F.H., me nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2018, e cila e denoncon subjektin për shkelje dhe për abuzime me detyrën si kryetare e gjykatës për largim të padrejtë nga detyra, për shkelje të ligjit për arkivën e shtetit dhe ligjit organik për rregullimin dhe funksionimin e gjykatës.
3. Denoncim i shtetases D.M., me nr. \*\*\* prot., datë 31.7.2018, e cila denoncon subjektin për largim të padrejtë nga puna, për shkelje dhe për abuzime me detyrën si kryetare e gjykatës.
4. Denoncim i shtetases M.C., me nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2018, e cila denoncon subjektin për shkelje dhe për abuzime me detyrën si kryetare e gjykatës. Denoncuesja ka vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për rikthim në punë dhe për pagimin e pagës deri në momentin e kthimit në punë.
5. Denoncim i shtetases B.M., me nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2019, e cila denoncon subjektin për shkelje dhe për abuzime me detyrën si kryetare e gjykatës dhe për largim të padrejtë nga puna.
6. Denoncim i shtetasit A.K., me nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2019, i cili denoncon subjektin për aftësitë profesionale bazuar në 2 fakte të njohura në mënyrë publike për subjektin e rivlerësimit.
7. Denoncim i shtetasit B.I., me nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2018, i cili denoncon subjektin për shkelje dhe për abuzime me detyrën si kryetare e gjykatës.
8. Denoncim i shtetasit A.T., me nr. \*\*\* prot., datë 7.1.2019, i cili denoncon subjektin për vendim të padrejtë të pambështetur në prova dhe fakte.

Lidhur me këto denoncime subjekti paraqiti shpjegime në përgjigje të rezultateve të hetimit.

Komisioni pas analizimit të denoncimeve dhe përgjigjeve të sjella nga subjekti i rivlerësimit, konkludoi se nuk rezulton indice apo prova bazuar në denoncimet lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

## **V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Në vlerësimin tërësor të çështjes mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave arrin në përfundimin se:

#### **A. Për vlerësimin e pasurisë**

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit subjekti nuk ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe të interesave private, si edhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Ajo është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës, i ka parashikuar të tilla që zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për sa më sipër, Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato *cash*) dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtare.

#### **B. Për vlerësimin e figurës**

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

#### **C. Për vlerësimin e aftësive profesionale**

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional trupi gjykues pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të gërmës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gërmës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, me detyrë gjyqtare/kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.06.2019

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtar**  
(Mendim paralel)

**Roland ILIA**  
**Relator**

*Gledis Hajdini*  
*Sekretare gjyqësore*